



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 453/ 5 prot.

Datë 20.02.2026

V E N D I M

Nr. 289/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.02.2026 me:

Objekt: Mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Marketing & Distribution ShPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik Marketing & Distribution ShPK me Nipt. J72124001N dhe adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga Iliria, Nr. 53 Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi 4 Heronjtë, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “*Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026*”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6321, datë 12.02.2026 dhe me nr. 453/2026 prot., datë 12.02.2026 i operatorit ekonomik Marketing & Distribution ShPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë me postë shkresën me Nr.3130 prot., datë 13.02.2026, protokolluar me tonën me Nr. 453/1, datë 16.02.2026, me objekt: Vendim lidhur me ankesën me nr. Prot., 453/2026 datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor informon se ka pranuar pretendimet e ngritura në ankesë mbi ndryshime të dokumenteve standarde të tenderit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikim të dokumenteve standarde të tenderit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK argumenton në ankesën e tij kërkesa mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në mënyrë të përmbledhursi vijon:

Në DST, në shtojcën nr. 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” është kërkuar afati i lëvrimit nga ana Juaj si më poshtë: Afatet e lëvrimit: Brenda 10 diteve nga njoftimi i AK. Pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, kjo pasi bëhet fjalë për furnizimin me sasi të konsiderueshme të artikujve (pajisje zyre, kancelari, letër dhe shtypshkrime të ndryshme) të cilët prodhohen dhe importohen nga furnitorë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Përsa më sipër kërkojmë, të ndryshohet ky afat lëvrimi dhe të bëhet brenda 30 (ditëve) nga lidhja e kontratës. AK duhet te percaktoje nje afat te arsyeshem ...

Gjithashtu në shtojcën 6 “Specifikimet teknike” është kërkuar ndër të tjera nga ana Juaj si më poshtë:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

	Specifikimet teknike	Pretendime te OE-së	
2	Libri i sekretarise	Regjistrimi i korespondences hyrese dhe dalese . Evidentim zyrtar te dokumentave, Liber fizik A4	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen per modelin
3	Liber poste A4 me 200 flete	I pershtatshem per tender, katalog ose pershkrim produkti. Format A4 nr. i fleteve (210x297mm) nr. i fleteve 80 ose sipas kerkeses.	Kerkojme te specifikohen nr. i faqeve 200 apo 80 ? kane diference ne cmim
4	Lidhje regjistrash Keshilli Bashkiak	Karton I forte ose material i trashe mbrojtes. Me lidhje te forte dhe te qendrueshme (me qepje ose spirale metalike) format A4	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
6	Liber llogarie	Karton I forte lekure ose material i trashe mbrojtes me lidhje te forte (me qepje profesionale ose ngjitje industrial) format A4 rezistente ndaj perdorimit Nr. I fleteve sipas nevojës se institucionit(200-500fl)	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen 200 dhe 500 kane diference ne cmim
7	Ditar arke i madh	Karton I forte lekure ose material i trashe mbrojtes me lidhje te forte (me qepje profesionale ose ngjitje industrial) format A4 rezistente ndaj perdorimit (300-500fl)	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen 300 dhe 500 ka diference ne cmim

8	Blllok fletedalje	Format A5ose A4, flete te numeruar radhazi me kopje (karbon ose vetekopjuese)trashesia 60-80 gr per m2	Kerkojme percaktim formati A4 apo A5 kane cmime te ndryshme
9	Blllok fletehyrje	Format A5ose A4, flete te numeruar radhazi me kopje (karbon ose vetekopjuese)trashesia 60-80 gr. per m2	Kerkojme percaktim formati A4 apo A5 kane cmime te ndryshme
10	Mandat arketimi	Format A5ose A4, leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 60-80 per m ²	Kerkojme percaktim formati A4 apo A5 kane cmime te ndryshme
11	Mandat pagese	Format A5 ose A4, leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 60-80 per m ²	Kerkojme percaktim formati A4 apo A5 kane cmime te ndryshme
12	Listeprezenca e madhe	Format A4 leter e bardhe, cilesi e mire trashesia 80 gr per m ²	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
13	Liber page	Format A4, leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 80 per m ² 200-500 flete	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen 200 dhe 500 kane diference ne cmim
14	Ditar magazine I madh partitar	A4 leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 80 per m ² 200-500 flete, karton i forte	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen 200 dhe 500 kane diference ne cmim
15	Libreze e taksave bujqesore, me ngjyra karton kolor	Format A4 leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 80 per m ²	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
16	Regjister korespondence A3x100 flete	Format A3 leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 80 per m ² . 100-200 flete sipas kerkeses.	Kerkojme specifikim te numrit te faqeve. 100-200 ka diference ne cmim
17	Libra buxheti	A4 leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 80 per m ² , lidhje e forte (qepje ose spirale)200-500 flete	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen 200 dhe 500 kane diference ne cmim
18	Akt kontrolli tatim taksash	A4 A4 leter e bardhe cilesi e mire, e ndritshme, trashesia 80 per m ² , lidhje e forte (qepje ose spirale)200-500 flete	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen 200 dhe 500 kane diference ne cmim
19	Liber vleresimi tatimor per subjektet	Dokument ku regjistrohen te dhenat financiare per qellime tatimore. Sherben si baze per llogaritjen dhe deklarim taksash ndaj administrates tatimore.	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen.
20	Regjister I arketimeve	Liber ku regjistrohen te dhenat financiare per qellime tatimore.	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen

21	Tatim taksat, liber kod vendor	Regjister per shitje/arketime tek vendoret (shites,furnitor)	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
22	Regjister korespodence A3	Perdoret ne administrate per evidentimin e shkresave hyrese dhe dalese, gjurmueshmeri. Arkivim dhe kontroll administrative.	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
23	Liber sherbimi 200 flete Policia Bashkiake	Te regjistroje te gjitha sherbimet e kryera. Leter standard A4 ose A5. Lidhje me spirale te forte	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
24	Fature per arketim	Dokumente zyrtare ose fature per shitje mallrash ose per tregjet	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
25	Bileta tregu Qendra Administrative Novosele	Fature e thjeshte per te regjistruar shitjet e kryera	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
26	Regjister indeks paaftesie	Dokument ne forme regjistri per te dokumentuar te dhena per ndihma pagesash, sherbimesh	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
27	Vertetim Rajoni 100	Dokument per qellime administrative me te dhena per person	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
28	Vertetim Rajoni 500	Dokument per qellime administrative me te dhena per person	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
29	Akt kontrolli Policia Bashkiake	Dokument per te regjistruar shkelje administrative, te dhenat per subjektet qe kontrollojne, ora, data etj	Kerkojme specifikime , foto ose modele dhe sa faqe kerkohen
30	Letër fotokopje, 80gr/m ² , A4	Përmasa A4 (297mm x 210 mm); -Lëmueshmëria: 80-130 ml/min sipas ISO 8791-2; - Lagështia: 3.5-4.5% sipas ISO 287; -Trashësia: 103-115 µm sipas ISO 534; -Shkëlqimi: 101-115% sipas ISO 2470-2; - Dukshmëria >94% sipas ISO 2471; - CIE bardhësia: 148-170 sipas ISO 11475; -Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706	AK ka kerkuar specifikime te detajuara. Sqaroni metoden e verifikimeve te tyre nga AK Nuk ka kerkuar skede teknike ne Kritere
38	Dosje plastike me llastik 2cm	Dosje plastike me llastik 2cm, format A4.Te mbyllet me ndihmen e llastikut qe te ruaj mire materialet	Kerkojme që elementi plastike te zvd me elemente kartoni i plastifikuar. Nuk ndikon në funksionin e artikullit
56	Dosje me llastik te gjere 4 cm	Dosje plastike me llastik, trashesia 4 cm, format A4, te kete nga brenda kapak per fiksimin e materialeve dhe te mbyllet me llastik me ngjyra te ndryshme.	Kerkojme qe elementi plastike te zvd me elemente kartoni

57	Dosje me buton nr.15 plastike	Te jete material kartoni, te kete kapse (percine) per mbylljen e dosjes ne brendesi te kete kapak fiksues me percina per fiksimin e materialeve ne te 2 krahet anesore, te jete me permasa 34x24x15 cm me marzh gabimi deri ne 5%, me ngjyra te ndryshme.	Kerkojme qe elementi plastike te zvd me elemente kartoni
58	Dosje kuti arkivi me lidhese 15cm	Materiali prej kartoni te kete kapese per mbylljen e dosjes, ne brendesi te kete kapak fiksues me percina per fiksimin e materialeve ne te 2 krahet anesor	Specifikimet te ndryshohen dhe te lidhen me emertimin e artikullit, nese jane dosje me lidhese apo me butona. Dosjet kane karakteristika te ndryshme.

Specifikimet e vendosura për artikujt nuk janë të plota, pa marzhe mungojne të dhënat e nevojshme për ofertim dhe një konkurim të drejtë e jo diskriminues... specifikimet e tilla bien ndesh me direktiven 24/2024, neni 42 “Per Prokurimi Publik” të KE-së ku parashikohet se Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat për produkte ose shërbime me cilësinë e kërkuar...[...]

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranimin e ankesës.

[...] Komisioni i Shqyrtimit të ankesës ne lidhje me modifikimin e afatit të lëvrimin ka pranuar të ndryshoje afatin nga 10 ditë në 30 dite.

Në lidhje me modifikimet të specifikimeve teknike për artikujt objekt ankimi i ka pranuar pretendimet dhe do të kryejë modifikimet e shtojcës 6, Specifikime teknike. [...]

Ankesa e operatorit ekonomik pranohet.

III. 2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.2.1. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.3. Për sa më sipër konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK, për modifikime të shtojcës 6 dhe 7 në procedurën e prokurimit sipërcituar duke përbushur qëllimin e ankimuesit.

Autoriteti kontraktor të përpilojë shtojcën me të gjitha modifikimet e kërkuara nga operatori ekonomik dhe pranuar nga KSHA me Vendimin nr. 3130 Prot, date 13.02.2026, duke e publikuar në SPE për të gjithë operatorët e interesuar.

Përsa konstatuar nga Informacioni i AK-së, mbi pranimin e plotë të ankesës, Komisioni gjykon të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Përsa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit duke përpiluar shtojcën sipas vendimmarrjes së KSHA-së, dhe publikuar në SPE.
3. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

